

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"Ç & M" Sh.p.k**

**I. THEMELIMI**

**NENI 1  
Ortakët themelues**

Shoqëria krijohet nga ortaku themelues:

- Znj.Minushe Çepele, shtetase shqiptare, lindur më 25/12/1955 në Imsht, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi F562250210, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

**II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI**

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqëria emertohet **"Ç & M" Sh.p.k**

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare".

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqëria **"Ç & M" Sh.p.k** e ka selinë e saj në adresën: Fier, Njesia administrative Mbrostar, Fshati Kallmi I Madh, Objekti ish Salla e pompave, zona kadastrale nr 2050, numri I parceles 76.

4.2 Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave të përfaqësimit ose agjensite të saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe do të veprojnë nën mbikqyrjen e Administratorëve të **"Ç & M" Sh.p.k.**

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria **"Ç & M" Sh.p.k** ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislati shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqerisë "Ç & M" Sh.p.k, do të ketë për objekt: Peshore industriale për mjete të tonazhit të rende.Bar bufe.

5.3 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqerise mund të ndryshoje, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të Asamblesë së Pergjithshme.

### III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

#### NENI 6

#### Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

#### NENI 7

#### Kapitali i Shoqerise

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise "Ç & M" Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere totale 100,000 (njqind mij) leke e cila nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- Znj.Minushe Çepele : Zoteruese i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 100,000 (njqind mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### NENI 8

#### Asambleja e Pergjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "Ç & M" Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anulimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

**NENI 9**  
**Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

**NENI 10**  
**Administratori i Shoqërisë**

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

10.2 Administratori është të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qendrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetesh.

10.4 Administratori e pare të shoqërisë emerohet:

Z. Ervin Çepele, shtetas shqiptar, lindur më 26/02/1983 në Kallmi i Madh, Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi I30226015K, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar I cili emerohet për një periudhë 5 (pese) vjecare.

Nënshkrimi i administratorit \_\_\_\_\_



10.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

**NENI 11**  
**Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet**

11.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, referencë i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

11.2. Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortaku themelues

**ORTAKU THEMELUES**

**Znj.Minushe ÇEPELE**



**Data: 04/06/2024**